



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1714/1 Prot.

Tiranë, më 16.10.2025

VENDIM

Nr. 51, Datë 16.10.2025

PËR

**RIALOKIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMEVE MASTER, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË FAKULTETIN E
ARTIT SKENIK, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në nenin 38, nenin 69 e në vijim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nisur nga kërkesat e Përgjegjësve të Njesisë Bazë Skenografi-Kostumografi dhe Koreografi si dhe Regji dhe Regji Filmi & TV, përcjellë përmes Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik me shkresën nr. 1714 prot., të 15.10.2025 dhe me lëndë “Kërkesë për rialokim kuotash në dy programe studimi në ciklin e dytë të studimeve Master”, për kuotat e miratuara nga Senati Akademik me Vendimin Nr. 12, datë 04.02.2025 “Për deklarimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë Bachelor dhe të ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve”, pasi diskutoi kërkesën e FAS,

VENDOSI:

1. Rialokimin e kuotave të pranimit të studentëve të ciklit të dytë Master, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve, si më poshtë:
 - Programi i studimit Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi merr 3 (tri) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat “Nga trojet sipas shteteve” të programit të studimit Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi.
 - Programi i studimit Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi merr 6 (gjashtë) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat “Nga trojet sipas shteteve” të programit të studimit Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi.
 - Programi i studimit Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi merr 3 (tre) nga 14 (katërmëdhjetë) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat e Departamentit Skenografi-Koreografi, të brendshme dhe nga trojet.



2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe të përcillet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Dr. Erald Bakalli

Prof. Najada Hamza

Prof. Arben Llozi

Prof. Miltiadh Kutali

Prof. Sadik Spahija

Prof. Lorenc Radovani

Prof. Vladimir Myrtezaj (Grosha)

Prof. Endri Sina

Prof. Rudina Ciko

Prof. Gazmend Gjoka

Prof. Asoc. Dorian Çene

Prof. Asoc. Albes Fusha

Prof. Asoc. Edmond Gjokopulli

Prof. Asoc. Kristina Laço

Prof. Asoc. Genci Fuga

Prof. Asoc. Alert Çeloaliaj

Prof. Asoc. Orion Shima

Enea Trimi (Student FAB)

Rei Kita (Student FM)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEKANI

Nr. 1414 prot.

Tiranë, më 15/10/2025

Lënda: Kërkesë për rialokim kuotash në dy programe studimi në ciklin e dytë të studimeve
Master i Arteve .

REKTORIT TE UNIVERSITETIT TE ARTEVE

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Zoti Rektor!

Në vijimësi të komunikimeve tona, nëpërmjet kësaj shkrese kërkoj nga ana Juaj rialokim të **3 (tri) kuotave në Ciklin e Dytë të studimeve Master i Arteve** në programin e studimit **Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi** në Fakultetin e Artit Skenik, si dhe të **6 (gjashtë) kuotave në Ciklin e Dytë të studimeve Master i Arteve** në programin e studimit **Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi**.

Duke parë rezultatet e konkurrentëve në konkurset e pranimit në programet e studimit **Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi, Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi** si dhe **Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi**, vlerësimi me pikë i disa kandidatëve poshtë vijës së kuqe pjesëmarrës në konkurs, është mbi nivelin 40 pikëve, limit që mundëson renditjen fituese në rast të kuotave të mjaftueshme..

Në Vendimin e Senatit Akademik të UART VSA Nr.12, dt. 04/02/2025 "Për Deklarimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe të Ciklit të Dytë të Studimeve me Kohë të Plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për Vitin Akademik 2025 -2026, në Universitetin e Arteve", për ciklin e dytë të studimeve Master në Fakultetin e Artit Skenik janë miratuar në total 102 (njëqind e dy) kuota në total në gjithë programet e studimit.

Vë në dukje se nga kuotat për trojet në dy programet e studimit të sipërpërmendura nuk është shfrytëzuar asnjë kuota.




Nisur nga sa më sipër, si dhe nga fakti se në programin e studimit **Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi, Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi si dhe Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi**, vlerësimi me pikë i disa kandidatëve poshtë vijës së kuqe, pjesëmarrës në konkurs, është në nivelin e mbi 40 (dyzetë)

pikëve, pra mbi prapun e përcaktuar me vendimin e Senatit Akademik Nr.12, dt. 04/02/2025 *“Për Deklarimin e Kuotave të Pranimi të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe të Ciklit të Dytë të Studimeve me Kohë të Plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për Vitin Akademik 2025 -2026, në Universitetin e Arteve”*, Departamenti Regji –Regji Filmi dhe TV ka paraqitur një kërkesë për rialokim kuotash dhe konkretisht kërkojnë:

- 3 (tri) kuotë e pashfrytëzuar nga kuotat “Nga trojet sipas shteteve” në programin e studimit Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi të rishpërndahet dhe të kalojnë në dobi të programit të studimit Regji Teatri & Spektakli dhe Mësuesi.
- 6 (gjashtë) kuotë të pashfrytëzuara nga kuotat “Nga trojet sipas shteteve” në programin e studimit Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi të rishpërndahet dhe të kalojnë në dobi të programit të studimit Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi.
- 3 (tri) kuotë të pashfrytëzuara në Departamentin Skenografi – Koreografi, nga 14 (katërmbadhjetë) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat e departamentit, të brendshme dhe nga trojet, të cilat të rishpërndahen dhe të kalojnë në dobi të programit të studimit Skenografi – Kostumografi dhe Mësuesi.

Bashkangjitur po ju dërgoj edhe kërkesën e Departamentit.

Ju faleminderit.


Prof. Miltiadh KUTALI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
NJËSIA BAZË REGJI DHE REGJI FILMI & TELEVIZIONI

Nr ____ prot.

Tiranë, më 10/10/2025

Lënda: Kërkesë për rialokimin e kuotave të papërdorura (2025-2026) në programet e studimit të Ciklit të Dytë në RFTV.

Drejtuar: Dekanit të FAS, Prof. Miltiadh KUTALI.

KËRKESË

I nderuar Z. Dekan,

Bazuar në urdhrin Tuaj Nr. 16, dt. 06/10/2025 për "Marrjen e Masave Organizative për Konkursin e Pranimit në Ciklin e Dytë për Vitin Akademik 2025 -2026 në Fakultetin e Artit Skenik, Universiteti i Arteve" dhe Urdhrin Tuaj Nr.17 dt. 08/10/2025 për "Ngritjen e Komisioneve për Konkursin e Pranimit në Ciklin e Dytë të Studimeve për Vitin Akademik 2025 -2026 në Fakultetin e Artit Skenik", në Njësinë Bazë Regji dhe Regji Filmi dhe TV në datën 08/10/2025 u zhvilluan konkurset e pranimit në Ciklin e Dytë Master i Arteve në të gjitha programet e studimit në varësi të kësaj njësie bazë.

Pas përfundimit të vlerësimeve nga ana e komisioneve rezulton se në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Teatri dhe Spektakli & Mësuesi kemi 11 (njëmbëdhjetë) kandidatë me pikë fituese të cilët konkurrojnë për 8 (tetë) kuota "Për kandidatë brenda territorit të vendit" sipas përcaktimeve të tabelës nr. 12 (fq. 20) të VSA Nr.12, dt. 04/02/2025 "Për Deklarimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe të Ciklit të Dytë të Studimeve me Kohë të Plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për Vitin Akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve".

Po ashtu, pas përfundimit të vlerësimeve rezulton se në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi kemi 12 (dymbëdhjetë) kandidatë me pikë fituese të cilët konkurrojnë për 6 (gjashtë) kuota "Për kandidatë brenda territorit të vendit" sipas përcaktimeve të tabelës nr. 12 (fq. 20) të VSA Nr.12, dt. 04/02/2025 "Për Deklarimin e Kuotave të Pranimit të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe të Ciklit të Dytë të Studimeve me Kohë të Plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për Vitin Akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve".

Nisur nga rezultatet e arritura nga kandidatët në këtë proces, nga pikët e kandidatit të fundit me pikë fituese në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Teatri dhe Spektakli & Mësuesi (62.00 (gjashtëdhjetëdy pikë zerozero), nga minimalja 40





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

(dyzet) pikë fituese; nga pikët e kandidatit të fundit me pikë fituese në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi (45.99 (dyzetepesë pikë nëntëdhjetëenëntë), nga minimalja 40 (dyzet) pikë fituese; si dhe bazuar në faktin se numri i studentëve fitues është gjithsesi më i ulët se kapacitetet maksimale pritëse të programeve të mësipërme të studimit të shprehura në tabelën nr. 12 (fq. 20) të VSA Nr.12, dt. 04/02/2025 “Për Deklarimin e Kuotave të Pranimi të Studentëve të Ciklit të Parë të Studimeve me Kohë të Plotë Bachelor dhe të Ciklit të Dytë të Studimeve me Kohë të Plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional për Vitin Akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve”, Ju paraqes këtu kërkesën për rialokim të 3 (tri) kuotave nga “Kuotat nga Trojet Sipas Shteteve” në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Teatri dhe Spektakli & Mësuesi dhe 6 (gjashtë) kuotave nga “Kuotat nga Trojet Sipas Shteteve” në programin e studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në Regji Filmi & Televizioni dhe Mësuesi.

Dua të theksoj se edhe këtë vit prurjet kanë qenë vërtet mbresëlënëse dhe se pranimi i këtyre profesionistëve të rinj që vijnë edhe me një bagazh serioz në përballjen me tregun e punës do të sillte rritjen e konkurrencës brenda kurseve të sipërpërmendura dhe rrjedhimisht edhe të cilësisë së produktit që do t’i ofrojnë nesër hapësirës kulturore këtë programe studimi.

I nderuar Z. Dekan, duke shpresuar së pari në mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj, lutem përcilluani këtë kërkesë Rektorit të UART Prof. dr. Erald BAKALLI si dhe Senatit Akademik të UART për miratim.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Përgjegjësi i Njesisë Bazë

Prof. as. Alert ÇELOALIAJ



UNIVERSITETI I ARTEVE
FAKULTETI I ARTIT SKENIK
DEPARTAMENTI SKENOGRAFI-KOREOGRAFI

TIRANË 09/10/2025

LËNDA: Kërkesë për rialokim kuote në ciklin e dytë të studimeve Master i Arteve.

Drejtuar: DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK
Prof. Miltiadh KUTALI

Zoti Dekan!

Këto ditë ne si departament zhvilluam konkursin e pranimi për studentët e ciklit të dytë të studimeve master i arteve.

Me Vendimin e Senatit Akademik të UART nr.08 datë 27.04.2021 "*Mbi deklarimin e kuotave të pranimi të studentëve të ciklit të parë me kohë të plotë Bachelor dhe ciklit të dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve / Master i Shkencave dhe Master Profesional për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve*", për departamentin Skenografi-Koreografi të Fakultetin e Artit Skenik janë miratuar 18 (tetëmbëdhjetë) kuota për kandidatët brenda territorit të vëndit. Nga këto kuota janë realizuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) kuota. Gjithashtu vë në dukje se kanë ngelur pa u shfrytëzuar edhe 12 (dymbëdhjetë) kuota të përcaktuara për trojet.

Në konkursin e pranimi për **skenografi – kostumografi dhe mësuesi** në Fakultetin e Artit Skenik janë paraqitur gjithsej 13 (trembëdhjetë) kandidatë dhe janë shpallur fitues 10 (dhjetë) prej tyre.

Në konkursin e pranimi për **skenografi – kostumografi dhe mësuesi** në Fakultetin e Artit Skenik nga 10 (dhjetë) kuota të miratuara, kanë konkuruar gjithsej 13 (trembëdhjetë) kandidatë dhe janë shpallur fitues 10 (dhjetë) prej tyre.

Nisur nga sa më sipër si dhe nga fakti se në programin e studimit **skenografi – kostumografi dhe mësuesi** vlerësimi me pikë i një kandidati poshtë vijës së kuqe, pjesëmarrësit në konkurs, janë në nivelin fitues të pikëve, Departamenti Skenografi-Koreografi paraqet këtë kërkesë për rialokim kuote dhe konkretisht kërkojmë:

- **3 (tre) kuota të pashfrytëzuara në Departamentin Skenografi-Koreografi nga 14 (katërmëdhjetë) kuota të pashfrytëzuara nga kuotat e Departamentit, të brendshme dhe nga trojet, të cilat të rishpërndahen dhe të kalojë në dobi të programit të studimit Skenografi-Kostumografi dhe Mësuesi.**

Ju lutem që kërkesa jonë të gjejë miratimin tuaj për procedure të mëtejshme në Senatin Akademik.

Prof.asoc. Taulant PUSTINA

Përgjegjës i departamentit

